



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2240/ Prot
2

Rrëshen, më 29 . 05 . 2026

V E N D I M

Nr. 38 datë 26. 05. 2026

PËR

“MIRATIMIN, PËRDORIM FOND MBROJTJES CIVILE”, BASHKIA MIRDITË

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligji nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, Udhëzimin nr. 9, datë 20. 07. 2018, i Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin nr. 35, datë 29.12.2023, “Për procedurat e menaxhimit të vështërsive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” pika 52, Udhëzimin nr. 2, datë 14.01.2026, “Për zbatimin e buxhetit 2026”, Vendimin nr. 98, datë 10.12.2025, të Këshillit Bashkiak Mirditë, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026”, Vendimin nr. 22, datë 19.03.2026, të Këshillit Bashkiak Mirditë, “Për miratimin e fondeve të trashëguara nga buxheti i vitit 2025, për buxhetin e vitit 2026”, *Relacion mbi situatën financiare të Bashkisë deri me datë 30.04.2026; (nr. 2207 prot, datë 18.05.2026)*, së bashku me projekt-vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, pas shqyrtimit dhe miratimit, në mbledhjen e datës 25.05.2026, të Komisionit të Ekonomisë, Financave dhe Buxhetit, për t’ia kaluar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

V E N D O S I:

1. Të miratojë përdorim (pjesërisht)fond mbrojtjes civile, në shumën totale (a+b); **1 947 046** (një milion e nëntëqind e dyzet e shtatë mijë e zero dyzet e gjashtë) lekë, si më poshtë;

- a) Fond mbrojtjes civile: **Gr.17 Tit.10910 Kap.1 Art.604 Kod prod 91707 AB**, për shumën **1 313 200 lekë**, të përdoret për shpenzime operative për forcat dhe mjetet e ushtrisë për ndërhyrjen në urën tip bejli, në fshatin Jezull, njësia administrative Rrëshen, sipas zërave të kërkuar;

a/1 - Naftë;.....306 000 lekë
a/2 - Lubrifikant;.....31 200 lekë
a/3 - Dieta;.....946 000 lekë
a/4 - Shpenzime të tjera;.....30 000 lekë

Shuma;.....1 313 200 lekë

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRËSHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

b) Fond mbrojtjes civile: **Gr.17 Tit 10910 Kap.1 Art.231 Kod prod 21AD502**, për shumën **633 846 lekë**, të përdoret për blerje materiale ndërtimi (dërrasë dhe vida betoni, sipas preventivit), për ndërhyrjen në urën tip bejli, në fshatin Jezull, njësi administrative Rreshen

2. Relacioni nr. 2240 prot, datë 19.05.2026, së bashku me preventivin, *bashkëlidhur, pjesë përbërse e këtij vendimi*
3. Shpenzimet do të kryhen dhe lekuidohen, sipas akt-marrëveshjes që do të lidhet mes palëve; (Bashkia Mirditë & Ministria e Mbrojtjes)
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë; (Drejtoria Juridike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksat, Agjencia e Inspektimit, Kontrollit dhe Emergjencave & APPM-Mirditë)

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.


SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR

Aleksandër PICAË





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MIRDITË

KËSHILLI I BASHKISË MIRDITË

P/V E N D I M
Nr. 49 date 19.05.2026

Nr. 2240 prot
1

Rreshen me 19/05 /2026

“PËR PËRDORIM FOND MBROJTJE CIVILE”

Mbështetur në ligjit 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ne ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligji nr.45/2019 “Per mbrojtjen civile”, 87/2025, “Per buxhetin e vitit 2026”, vkm nr.414, dt.08.07.2021 “Per miratimin e procedurave dhe kriterëve te ndarjes dhe te perdorimit te fondit te kushtezuar te buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile” i ndryshuar, “Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, në udhëzimin nr.2, datë.14.01.2026, “Për zbatimin e buxhetit 2026”, shkresen e Ministrise se Mbrojtjes nr.2222/1 prot, date.03.03.2026 “Kthim pergjigje”, relacionin, preventivin e sektorit te emergjencave civile dhe urbanistikes , Këshilli i Bashkisë Mirditë, pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i Bashkise;

V E N D O S I:

1. Të miratojë perdorimin(pjeserisht), te fondit te mbrojtjes civile, si me poshte.:

- a- Fondi mbrojtje civile: **Gr. 17 Tit. 10910 Kap.1 Art. 604 kod prod 91707AB për shumën 1 313 200 leke**, te perdoret per shpenzime operative per forcat dhe mjetet e ushtrise per nderhyrjen ne uren tip beli ne fshatin Jezull, sipas zerave te kerkuar:
- | | |
|-----------------------------|-----------------------|
| a/1- Nafte..... | 306 000 leke |
| a/2-Lubrifikant..... | 31 200 leke |
| a/3-Dieta..... | 946 000 leke |
| a/4-Shpenzime te tjera..... | 30 000 leke |
| TOTAL..... | 1 313 200 LEKE |

b- Fondi mbrojtje civile: **Gr. 17 Tit. 10910 Kap.1 Art. 231 kod prod 21AD502 për shumën 633 846 leke**, te perdoret per blerje materjale ndertimi (derrase dhe vida betoni, sipas preventivit,) per nderhyrjen ne uren tip beli, ne fshatin Jezull:

2. Shpenzimet do kryhen dhe likujdohen, sipas akt-marrveshjes qe do lidhet ne mes paleve(Ministria e Mbrojtjes dhe Bashkia Mirdite).

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkise

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETARI

KRYETARI

Gaspër TOPOLLAJ

Aleksander PICAKU

Paraqiten projektin

Dr. AIKE:

F.Vorfi

Dr./zhvill ek dhe tatim taksat:: V.Gjoka

Pergj sekt juridik/prok:

M.Topollaj

Dr,PZHT:

J. Tusha



ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 222162223www.bashkiamirdite.gov.a



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 2240 Prot.

Rrëshen, më 19 . 05 .2026

Lënda: RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK MIRDITË

Të nderuar këshilltarë të bashkisë Mirditë!

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe në kuadër të mirëmbajtjes dhe përmirësimit të infrastrukturës publike në administrim të Bashkisë, paraqitet për miratim preventivi për blerje materialesh për riparim urës tip “Bejli” në fshatin Jezull, njësia administrative Rrëshen sipas kërkesës nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.

Nga verifikimet në terren dhe konstatimet teknike të kryera rezultojnë se është dëmtuar ura ekzistuese prej druri paraqet konsumim të elementëve të sipërfaqes së kalimit, duke sjellë amortizim të dërrasave dhe ulje të parametrave të sigurisë për përdoruesit. Për këtë arsye lind nevoja për ndërhyrje të menjëhershme me qëllim përfundimin dhe rehabilitimin e sipërfaqes së kalimit nëpërmjet shtesës me dërrasa druri me trashësi 5 cm dhe fiksimit të tyre me vida përkatëse.

Punimet e parashikuara konsistojnë në:

- furnizimin me dërrasa druri me trashësi 5 cm;
- montimin dhe fiksimin e tyre në strukturën ekzistuese të urës;
- përdorimin e vidave të betonit/druit për realizimin e lidhjeve dhe garantimin e qëndrueshmërisë së elementëve;
- sistemimin dhe përfundimin e sipërfaqes së kalimit.

Preventivi është hartuar mbi bazën e çmimeve përkatëse të analizave teknike dhe përfshin:

Nr	Emërtimi i punimeve	Njësia	Sasia	Vlera
1	Ura druri – shtesë me dërrasa, trashësi 5 cm	m ²	200	477,052 lekë
2	Vida betoni/dru	copë	2000	26,000 lekë

Vlera totale e analizës rezultojnë:

- Shuma e analizës: 503,052 lekë
- Fond rezervë 5%: 25,153 lekë
- Vlera me fond rezervë: 528,205 lekë
- TVSH 20%: 105,641 lekë

Shpenzimet operative në bazë të shkresës nr 1075 Prot. datë 06.03.2026 janë:

- faza e parë 805 800 lekë
- faza e dytë 507 400 lekë.

Vlera totale për miratim:

1 947 046 (Një milion e nëntëqind e dyzet e shtatë mijë e dyzet e gjashtë) lekë me TVSH.

Realizimi i këtyre punimeve është i domosdoshëm për:

- garantimin e sigurisë së përdoruesve;
- përmirësimin e kushteve të qarkullimit;
- shmangien e degradimit të mëtejshëm të strukturës ekzistuese;
- rritjen e jetëgjatësisë së objektit.

Për sa më sipër, kërkohet miratimi nga Këshilli Bashkiak i fondit në vlerën 1 947 046 lekë me TVSH për realizimin e punimeve të sipërcituara.

Shuma totale 1 947 046 leke me tvsh

Hartoi Relacionin:

Agjencia e Inspektimit, Kontrollit dhe Emergjencave

Frederik Vorfi



Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Ark Juljan Tusha



KRYETARI
Albert MELYSHI





MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISË MIRDI
ALBERT MËLYSHI

PREVENTIV

NR	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	VLERËTA MIRDITË
1	3.415/3	Ura druri. Shtese me derrasa, 5 cm	m2	200	2,385.26	477052
2	AN	Vida betoni	copë	2000	13.00	26000
Shuma Analiza						503052
Fondi Rezervë (5.0%)						25153
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%)						528205
Shuma me TVSH (20%)						105641
Totali 1						633846
3		Shpenzime Operative Faza 1				805800
4		Shpenzime Operative Faza 2				507400
Totali 2						1313200
TOTALI 1 + TOTALI 2						1947046

Preventivuesi:
ING. DAISLER PEPA

Shënime:
Bazuar ne VKM NR.216, Date 13.04.2023